

VENDIM
Nr. 213, datë 13.4.2023

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË
ELEKTRIKE EOLIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT
KONCESIONI, NË TRAGJAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE ORIKUM, QARKU
VLORË, NGA SHOQËRIA “SUNTECH POWER” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria “SUNTECH POWER” sh.p.k., me elementet si më poshtë vijon:

- a) Emri i aplikuesit: Shoqëria “SUNTECH POWER” sh.p.k.;
- b) Numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: L81906019T;
- c) Tipi i centralit: Eolik;
- ç) Kapaciteti i instaluar: 3 mw;
- d) Afati i pritshëm i vënies në punë: Koha për marrjen e lejes së ndërtimit, ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve;
- dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë;
- e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) Koordinatat e tokës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;
- g) Shoqërisë “SUNTECH POWER” sh.p.k. i lind e drejta të krijojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit një shoqëri për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit eolik;
- gj) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, me kapacitet të instaluar 3 mw, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, e dhënë sipas këtyre rregullave, si dhe më shumë se 10% e kuotave të shoqërisë, për qëllime të veçanta, mund të transferohet te një subjekt i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- h) Shoqëria “SUNTECH POWER” sh.p.k. ose shoqëria për qëllime të veçanta ka detyrimin që:
 - i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore ose institucioneve të tjera të autorizuar informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;
 - ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë “SUNTECH POWER” sh.p.k. ose shoqërisë për

qëllime të veçanta dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;



v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “*SUNTECH POWER*”, sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku


HARTA TOPOGRAFIKE SUNTECH POWER



Suntech
Power - KOSOVA

Legend	
—	RRIJE AKSESI
—	RRETHIMI
	hull territorial
	parcela
●	TURBINA, T1, SUNTECH POWER
●	QENDER, BANIMI

SUNTECH POWER			
WGS84 UTM 34N			
NR	X	Y	
1	377430.699	4463510.033	
2	377475.687	4463510.137	
3	377475.791	4463465.149	
4	377430.806	4463465.054	
TURBINA T1	377453.247	4463487.596	
KRRGJSH			
NR	X	Y	
1	462386.259	4464391.390	
2	462431.253	4464392.002	
3	462431.865	4464347.007	
4	462386.874	4464346.405	
TURBINA T1	462409.064	4464369.203	
GAUS KROGER ZONA 4			
NR	X	Y	
1	4377506.643	4465425.133	
2	4377551.650	4465425.237	
3	4377551.753	4465390.230	
4	4377506.750	4465390.136	
TURBINA T1	4377529.200	4465402.687	



1:2,000